0

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**
**TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**



# RAPORT TREMUJOR

(tetor - dhjetor 2020)

## PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK

Prishtinë, shkurt 2021

## 1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.

12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi "Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstitucional";
13. Koordinatori Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës "Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018".

Prokurori i Prokurorisë Themelore, Departamenti i Krimeve të Rënda në Gjilan, Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

## 2. ANALIZA&SUKSESET

Periudha e tremujorit të katërt e vitit 2020, tetor – dhjetor, sjell rezultate të përziera në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit. Sërish ka shifra të kënaqshme sa i përket sekuestrimit ndërsa shifra të ulëta të konfiskimit. Tremujori i fundit i vitit 2020 sjell ngrirje/sekuestrim në shumën prej 6,193,217.41 € ndërsa konfiskim në shumën prej 67,999.42 €.
Ajo që është pozitive është fakti se përderisa kemi pasur PSRK-në që kishte sjellë në një tremujor rezultate të konfiskimit, e më pas edhe PTH Prishtina, këtë tremujor të fundit është PTH Prizreni që sjell shumën prej rreth 68,000.00 € konfiskim në dy raste të caktuara (PP.I.nr.143/2019 dhe PP.II.nr.2360/2019).

**TOTALI PËR VITIN 2020: sa i përket totalit të vitit 2020, sistemi i drejtësisë ka gjeneruar shifra të mira tek ngrirja/sekuestrimi dhe kjo ilustrohet me faktin se kemi 19,182,157.01 € ndërsa shifrat e konfiskimit janë në shumën prej 476,490.38 €.**
**Pra rreth 20 milionë euro pasuri e sekuestruar dhe rreth gjysmë milioni pasuri përfundimisht e konfiskuar.**

**RASTET E KONFISKIMIT:**

1. Kështu, rasti i parë ka të bëjë me rastin PP.II.nr.2360-11/2019 e datës 02.12.2019, për shkak të veprave penale të mashtrimit të kryer në bashkëkryerje nga neni 323.4 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (prokurori i rastit Atnor Skoro), lëshimi i

çeçeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit të kryer në bashkëkryerje nga neni 301.3 lidhur me par. 2 e në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Në këtë rast kemi dy të pandehurit O.V dhe Z. V. të cilët kanë arritur marrëveshje të fajësisë me prokurorinë. Me këtë rast është rekomanduar që dënimi i shqiptuar të jetë mes 18 muajve deri në 24 muaj. Ndërsa shuma prej 62,521.42 € është konfiskuar si pjesë e shumës prej 140,130.00 € të cilën të pandehurit duhet t'ia kompensojnë të dëmtuarës, Bankës Kombëtare Tregtare. Janë konfiskuar edhe 2 telefonë Samsung si mjete të kryerjes së veprave penale dhe një sërë dokumentesh tjerë. Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.299/2020, datë 04.12.2020 dhe numri SMIL 2019:246865.

2. Ndërsa rasti i dytë ka të bëjë me rastin PP.I. nr.143/2019 e datës 08.11.2019 (aktakuza është ngritur nga PTh Prizreni, DKR), ku është ngritur aktakuzë kundër një të pandehuri, M.A., për shkak të veprës penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 164 paragraf1 dhe 8, pika 1 dhe 2 të KPRK-së. Është arritur marrëveshje e fajësisë me dt. 13.12.2019.

   Gjykata Themelore e Prizrenit, Departamenti për Krime të Rënda ka shpallur aktgjykimin fajësues PKR.nr.96/19 të datës 24.12.2019, ku i pandehuri dënohet me burgim prej 6 muajve dhe duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë prej 2,000.00 € si dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200.00 €. Gjykata ka vendosur edhe për konfiskimin e një telefoni të tipit Iphone 5, 1 samsung S8, 1 veturë të tipit Rover, 1 telefon samsung S4, 1 telefon të tipit Hauaëei.

Ajo që bie në sy tek të dy rastet e punuara nga PTh Prizreni, është se rastet kanë përfunduar relativisht shpejtë, meqenëse shihet se rastet i takojnë vitit 2019. Mirëpo meqenëse ka pasur marrëveshje të fajësisë, edhe procedura është zhvilluar shumë më shpejtë, që tregon edhe njëherë për përfitimet e mëdha nëse prokuroritë aplikojnë shumë më shpesh marrëveshjet e fajësisë.

Ajo që bie në sy është fakti se këtë vit në përgjithësi ka pasur konfiskime të herëpashershme, qoftë nga PSRK, qoftë nga PTH Prishtina apo edhe nga PTh Prizreni dhe gëzon fakti që kemi më shumë se një prokurori që kanë rezultate përfundimtare në konfiskim.

Shifrat në fjalë flasin për të satën herë me radhë për disproporcion të madh mes sekuestrimit në njërën anë dhe konfiskimit në anën tjetër. Pra, edhe këtë vit shifra e konfiskimit është e ulët ngase gjysmë milioni euro për një sistem të tërë juridik është shumë pak në krahasim me objektivat reale që do të duhej të plotësoheshin.

Nëse krahasojmë vitin 2020 me vitin 2019, atëherë vërejmë se konfiskimi ka rënë thuajse 100% sepse përderisa vitin e kaluar kemi pasur konfiskim në shumën prej gati 1 milion euro, këtë vit kemi rreth gjysmë milioni euro pasuri e konfiskuar përfundimisht. Ndërsa që tek sekuestrimi kemi rritje të shifrave këtë vit në krahasim me vitin 2019, edhe atë shifra të rritura ndjeshëm ngase prej rreth 9 milion euro pasuri të sekuestruar në vitin 2019, në vitin 2020 janë shënuar rreth 20 milionë euro pasuri e sekuestruar.

Andaj pavarësisht shifrave të sekuestrimit dhe konfiskimit të ndodhur në vitin 2020, megjithatë është po ashtu evidente se një gjë e tillë është e pamjaftueshme dhe se shifrat e konfiskimit duhet të rriten ndjeshëm. Duke mos dashur të përsërisim, ritheksojmë se më shumë seanca dhe dhënia priroritet rasteve me konfiskim, mund të jetë njëra nga pikat që përcakton sukses më të madh.

Ajo që mund të veçojmë si pozitive gjatë kësaj periudhe tremujore është fakti se konfiskimet, ngrirjet dhe sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë vepra penale kundër korrupsionit (keqpërdorimi i pozitës zyrtare, dhënie ryshfeti), krimeve ekonomike (ndër tjera edhe për shpëlarjen e parave), veprat penale kundër narkotikëve, armëve, financimi i terrorizmit, rrëmbim, mashtrimi, kontrabandimi i mallrave, tregtia e ndaluar, vjedhja e pyllit, vrasje të rëndë, grabitje, etj..

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 50 prokurorë (53 në TM3, 58 prokurorë në TM2 dhe 48 kanë qenë në TM1) janë përfshirë në sekuestrim të pasurisë në raste të ndryshme.

-Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuara gjatë vitit 2020 është negativ. Kështu të dhënat statistikore dëshmojnë se gjatë vitit 2020 janë pranuar gjithsej 380 raste të reja me 600 persona. Nga ky numër i rasteve të reja të pranuara, del se prokuroritë në nivel vendi kanë zgjidhur 325 raste me 478 persona. Edhe më saktë, duke përdorur përqindjen, del se prokuroritë kanë zgjidhur 85.52% të rasteve të pranuara dhe 79.66%

të rasteve me persona gjatë vitit 2020. Pra kontingjentit prej 369 rasteve të trashëguara nga viti 2019 i shtohen edhe 55 raste të reja me 122 persona, apo 14.48% më shumë raste dhe 20.34% më shumë me persona se sa kemi pasur të trashëguara më 2019.

| **Viti 2019** | **Viti 2020** |
|---|---|
| **369 kallëzime penale kundër 586 personave** | **424 kallëzime penale kundër 708 personave** |

KPK duhet ta ketë parasysh një gjendje të tillë dhe ta vlerësoj drejt e si duhet. Qëllimi do të duhej të jetë se si të reduktohen këto numra dhe jo të shtohen. Andaj KPK duhet të shikoj dhe analizojë nëse kryeprokurorët kanë pasur qasjen më të mirë të mundshme, nëse ata kanë ndonjë strategji se si të tejkalohet një situatë e tillë apo edhe të bëhet vlerësimi i performancës.

Poashtu KPK mund dhe në të vërtetë do të duhej të ketë parasysh se pandemia ka luajtur një rol në këtë drejtim, mirëpo kjo nuk duhet të jetë arsyetimi i parë dhe i vetëm, për faktin që nuk do të duhej të ndodhte, e ky është se tash kemi më shumë raste të pazgjidhura se sa kemi pasur më 2019.

Pra përderisa në fillim të vitit 2020 kemi pasur të trashëguara 369 kallëzime penale me 586 persona, në fillim të vitit 2021 kemi trashëguar 424 kallëzime penale me 708 persona.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 478 kallëzimeve penale të zgjidhura me persona nga krimet ekonomike, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 322 personave, apo në 67.36% (aktakuza të drejtëpërdrejta janë 54% dhe 13% me urdhër ndëshkimor), ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 69 personave apo në 14.43% të tyre, kanë hedhur kallëzimet penale kundër 86 personave apo në 17.99% të tyre dhe në 3 raste tjera kanë zgjidhur rastet në tjetër mënyrë ndërsa në 1 rast është propozuar masa e trajtimit psikiatrik.

-Te vepra penale e shpëlarjes së parave më 2020 kemi pasur 15 kallëzime penale kundër 39 personave ndërsa që janë zgjidhur 9 raste me 44 persona. Ndërsa mënyra e zgjidhjes për 44 persona është se kundër 1 personi ka pasur hedhje të kallëzimit penal, kundër 7 personave ka pasur pushim të hetimeve ndërsa kundër 33 personave tjerë ka pasur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve. Pra sikur që vërehet, PSRK ka zgjidhur më pak raste se sa janë pranuar sa u përket kallëzimeve penale, mirëpo ka zgjidhur më shumë raste me persona se sa që ka pranuar.

-Ndërsa kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive ngase kemi 57 vendime kur të akuzuarit janë shpallur fajtorë, në 5 raste është hedhur aktakuiza para shqyrtimit gjyqësor, në 11 raste i akuzuari është liruar nga aktakuza ndërsa në 3 raste është refuzuar aktakuza. Pra nga totali prej 76 vendimeve për persona, në 75% të tyre gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave kurse në 25% të rasteve, ose janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor apo 6.57%, në 14.47% të akuzuarit janë liruar nga aktakuza ndërsa në 3.94% është refuzuar aktakuza.

-Tek rastet e evidentuara si INFORMATA apo PPN-të, në fillim të vitit 2020 prokuroritë kanë trashëguar 275 informata kundër 341 personave. Në vitin 2020 janë pranuar 116 informata të reja me 121 persona. Prokuroritë kanë zgjidhur 144 informata me 157 persona. Ndërsa kanë mbetur të pakryera edhe 247 informata me 305 persona. Edhe pse ka një trend pozitiv të rasteve të kryera në raport me ato të pranuara gjatë këtij viti, megjithatë kërkohet një vendosmëri më madhe që reduktimi i rasteve me informata të jetë më efikas.

## 2.1 KONSTATIMET

Viti 2020 e gjen Kosovën dhe sistemin e saj të drejtësisë me rreth 20 milionë euro pasuri të ngrirë/sekuestruar dhe me rreth gjysmë milioni euro pasuri të konfiskuar përfundimisht.

Në krahasim me vitin 2019, Kosova dhe sistemi i saj ka shënuar progres tek ngrirja/sekuestrimi sepse nga më pak se rreth 9 milionë euro pasuri të ngrirë/sekuestruar më 2019, tash në vitin 2020 kemi rreth 20 milionë, që përbën një dallim të madh. Sidoqoftë, nënvizojmë faktin se bëhet fjalë vetëm për ngrirje/sekuestrim.

Kurse tek konfiskimi ka rënie në krahasim me vitin e kaluar, edhe pse edhe ky konstatim është relativ. E themi këtë duke u bazuar në faktin se në vitin 2019 është raportuar konfiskim në shumën prej rreth 1 milion euro ndërsa këtë vit kemi rreth gjysmë milioni euro pasuri të konfiskuar.

Mirëpo e kemi parasysh edhe faktin se rasti më i madh i konfiskimit të vitit të kaluar ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme.

Ndërsa vlen të theksohet edhe pandemia që këtë vit e ka karakterizuar tërë botën dhe se një një pjesë të konsiderueshme të vitit nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore. Natyrisht se kjo ka ndikuar apo ka mundur të ndikojë në konfiskim më të madh sikur të kishim më shumë seanca të mbajtura gjyqësore.

Anash arsyetimit me pandeminë, shifra prej rreth gjysmë milioni euro pasuri e konfiskuar konfirmon edhe njëherë tjetër problemin e shpërfaqur kaherë në sistemin e drejtësisë, e që ka të bëj me shifra tejet të ulëta të konfiskimit.

## 3. LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT

LKZK e re ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Çdo aktgjykim që merret pas datës së hyrjes në fuqi, ka mundësi që LKZK e re të aplikohet dhe kjo paraqet një mundësi të mirë për sistemin gjyqësor të vendit që shifrat e konfiskimeve t'i rrisë duke shfrytëzuar këtë ligj që është shumë më i fuqishëm se sa ai i kaluari.

Prokurori i Shtetit në mars të vitit 2020 ka iniciuar një rast nga LKZK e re (PPS.nr.54/2014). Ky rast është iniciuar nga PSRK. Rasti ka të bëjë me veprat penale si: krimi i organizuar, shpëlarja e parave dhe shmangia nga tatimet. Edhe pse ka kaluar gati 1 vit nga paraqitja e kërkesës, as sot e kësaj dite gjykata nuk ka caktuar ndonjë seancë për këtë rast.

Ne kemi identifikuar edhe disa raste potenciale, apo deri më tani janë identifikuar 6 raste të tilla. 5 raste të tilla janë identifikuar në PSRK kurse 1 tjetër në PTH Prishtinë. Më tutje është në diskrecionin e prokurorëve të vendosin nëse ka arsye dhe bazë ligjore për të vazhduar me konfiskimin e zgjeruar, gjithmonë nëse ka aktgjykim dënues. Mirëpo një rol të konsiderueshëm duhet ta kryejnë edhe kryeprokurorët dhe vetë KPK përmes mekanizmit të llogaridhënies.

Megjithatë, më shumë raste do të ishte e dëshirueshme të iniciohen dhe kryeprokurorët e secilës prokurori themelore dhe të PSRK-së do të duhej të identifikojnë rastet potenciale për aplikimin e LKZK-së së re.

Ndërsa kemi edhe 4 raste në proces e sipër, ku nga këto kemi 3 raste sipas ish LKZK-së dhe 1 rast e kemi sipas LKZK-së së re.

Moszbatimi i LKZK-së është një e metë serioze e sistemit të drejtësisë, dhe posaçërisht e sistemit prokurorial. Një gjë e tillë ka të ngjarë të vë Kosovën në tehun e kritikës sepse edhe pas kalimit të kohës prej 2 viteve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatimi i saj është larg, shumë larg nga sa do të ishte e dëshirueshme të ishte në realitet.

**TË REJAT:** më 28.12.2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka marrë Aktvendimin mbi Papranueshmërinë në rastin nr. KO5O/19, ku ishte parashtrues Gjykata Supreme e Republikës se Kosoves që kishte si objekt - Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 5 paragrafit 2, Nenit 7 paragrafeve 3, 4 dhe 5 te Ligjit nr. 04/L-140 per Kompetencat e Zgjeruara per Konfiskimin e Pasurisë së përfituar me vepër penale dhe nenit 19 paragrafit 1 nenparagrafit 1, paragrafit 2 nenparagrafit 1, si dhe paragrafeve 7 dhe 8 te Ligjit Nr. o6/L-087 per Kompetencat e Zgjeruara per Konfiskimin e Pasurisë.

Atë që e thotë Gjykata Kushtetuese me këtë aktvendim, është se kërkesa nga Gjykata Supreme e Kosovës është paraqitur pasiqë kjo gjykatë kishte vendosur tashmë në rastin e saj dhe se këtë në të vërtetë nuk ka mund ta bëj pasiqë para se ta vendos rastin në fjalë, Gjykata Supreme është dashur ta suspendojë vendosjen e rastit deri në marrjen e vendimit nga Gjylata Kushtetuese. Për rrjedhojë sipas Gjykatës Kushtetuese, kërkesa e paraqitur ka qenë e papranueshme dhe nuk është vendosur në mënyrë meritore.

## RAPORT TREMUJOR
## tetor – dhjetor 2020

## 4. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Legjislacioni:**

Divizioni është aktiv ne takimet e grupit punues për koncept dokument për plotësim ndryshim të ligjit PP/FT, është finalizuar udhëzimi për formularin e prejardhjes së fondeve në këtë periudhë edhe nga ana juridike dhe mbetet vetëm aprovimi në bord.

Kemi mbajtur takimin e parë virtual të komitetit drejtues të Projektit PECK III.

**Operacionet:**

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer 3 inspektime/ekzaminime në fushën PP/FT nga distanca në institucionet financiare si në vijim:

1. Kompania e Sigurimeve "PRISIG",
2. Kompania e Sigurimeve "Kosova e RE".
3. Institucionin mikrofinanciar "Kreditimi Rural i Kosovës (KRK)

**Bashkëpunimi dhe trajnimet:**
Faza e tretë e Projektit të përbashkët BE/Këshilli i Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECK III) ka filluar, me datë 07.12.2020 e kemi mbajte takimin e parë online ku ishim 32 pjesëmarrës dhe u diskutua për sfidat kryesore të projektit PECK III.

## 5. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Sipas mandatit të vet ligjor misioni i Njësisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NjIF-K) është të udhëheqë përpjekjet e qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i duhur i sistemit si tërësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njësisë për Inteligjencë Financiare është objektiva kryesore e NjIF-K.

Qëllimi strategjik i NjIF-K është të sigurojë një regjim efikas për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke zhvilluar proceset e veta të brendshme dhe metodat e punës të orientuara kah performanca, korniza ligjore dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar. Prioritetet Strategjike dhe objektivat e planit të performancës së NjIF-K në nivel institucional rezultojnë prej planeve të veprimit të strategjive kombëtare, vlerësimit të rreziqeve kombëtare dhe sektoriale, vlerësimit të gjithmbarshëm të vendit në fushën e PPP/LFT, programit të Qeverisë, PKZMSA, ERA, buxhetit dhe raporteve dhe dokumentave tjerë që janë në interes për NJIF-K.
Me datë 09.12.2020, Bordi Mbikqyrës i NJIF-K ka miratuar Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar (NRA) për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit, ndërsa më datë 24.12.2020 Qeveria e Kosovës ka miratuar NRA me vendim nr.04/52.
Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 24/12/2020 me Vendimin Nr. 05/52, ka aprovuar Planin e Veprimit të rekomanduar për përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti) si dhe shtojca 1 (Pjesa Teknike),

Shtojca 2 (Udhëzues për Zbatimin e Mjetit për Monitorimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit), Shtojca 3 (Mjet për Monitorimin e Zbatimit të Rekomandimeve nga Raporti i Vlerësimit).

Me datë 09.12.2020, NJIF-K dhe UNDP kanë organizuar seminarin "Partneriteti Publiko-Privat Kundër Pastrimit të Parave dhe për Pajtueshmërinë". Seminari online ka eksploruar praktikat më të mira në bashkëpunimin ndërmjet subjekteve raportuese të sektorit privat, NJIF-it dhe hetuesve, prokurorëve etj, përmes temave: Ndarja e informacionit mes bankave dhe subjekteve raportuese; Dizajnimi dhe zbatimi i sistemeve të pajtueshmërisë dhe kundër pastrimit të parave; Direktiva e 5-të e BE-së; Hetimet e bazuara në RTD dhe partneritetet publike private për hetimin e rasteve; Inteligjenca e korporatave dhe hetimet e drejtuara nga të dhënat dhe njerëzit.

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të marra në lidhje me ngritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informatave dhe qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme me datë 03/12/2020 kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprave të tjera penale që ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Në këtë periudhë rapotuese, NJIF-K ka hartuar Manualin për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik.

Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta të raportuara në këtë periudhë raportuese ka qenë 249 RTD. Numri i raporteve të shpërndara tek autoritetet tjera ka qenë 80 apo 4% më tepër se periudha e njejtë e vitit paraprak. Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2020 janë zhvilluar 20 inspektime të pajtueshmërisë.

Më datë 06 Tetor 2021, NJIF-K ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Drejtues te Procesit te Berlinit "Berlin Process - Security Commitments Steering Group Meeting"

Në muajin Dhjetor 2020, NJIF-K ka aprovuar Kodin e Mirësjelljes dhe Etikës profesionale për nënpunësit e NJIF-K.

Në këtë periudhë janë mbajtur trajnime, seminar dhe punëtori të ndryshme në fushën e PP/FT, aktivitete këto të organizuara nga ECOFEL, CEPOL, UNDP, GIZ, PECK III, Ambasada Amerikane etj.

## 6. POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka raportuar se gjatë këtij tremujori të katërt ka pasur këto aktivitete të trajnimit:

1. Mashtrimi dhe falsifikimi i mjeteve për pagesë jo me para të gatshme III: Marrja dhe parandalimi i llogarisë Online CEPOL 1 trajnim me 1 zyrtar,

2. Hetimet financiare te cilat ndërlidhen me përfitimet e migrimit ilegal Online CEPOL 1 trajnim me 1 zyrtarë;

3. Mashtrimi Financiar dhe Hetimi i Krimit Financiar Online OPDAT& ICITAP 1 trajnim me 7 zyrtarë.

## 7. STATISTIKAT E SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE

**Sekuestrimet, ngrirjet dhe konfiskimet për tremujorin e katërt për vitin 2020**

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të katërt (tetor-dhjetor) për vitin 2020 janë ngrirë, sekuestruar dhe janë konfiskuar si në vijim:

- 65 automjete (vetura, rimorkio, kombi, kamion etj.........................................................................................314,122.78 €

- Para kesh .........................................................................631,737.84 €

- Pajisje teknologjike( telefonë, kompjuterë, aparate)...............132,250.00 €

- Të tjera (duhan, krerë me gjedhe, veshmbathje, etj.)............ 147,434.79 €.

**Sekuestrime janë: 1,225,545.41 euro**

**Ngrirje: 4,967,672.00 euro.**

**<u>Totali i sekuestrimit dhe ngrirjes: 6,193,217.41 €</u>**

**<u>Totali për konfiskim: 67</u>,999.42 €.**

## 8. SEKUESTRIMET, NGRIRJET DHE KONFISKIMET PËR TREMUJORIN E IV TË VITIT 2020

| Nr. | Nr. I Prokurorisë | Vepra penale | Përshkrimi I pasurisë | Prokuroria | Data |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | PP/II.nr.1964-8/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 30.12.2020 |
| **2** | PP/II.nr.359-11/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 10.08.2020 |
| **3** | PP/I.nr.250/2020 | Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par. 2 të KP-së | Para | P.Th. Prizren | 24.12.2020 |
| **4** | PP/II.nr.2775-16/19 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 15.01.2020 |
| **5** | PPN/II.nr.802-8/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 01.12.2020 |
| **6** | PPN/I.nr.284/2020 | Kontrabandim me migrantë neni 164 par 1 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 22.10.2020 |
| **7** | PP/I.nr.217/20 | Kontrabandim me migrantë neni 164 par 1 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 11.11.2020 |
| **8** | PPN/II.nr.738-12/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 03.11.2020 |
| **9** | PPN/II.nr.321-12/20 | Hyrje në sistemin kompjuterik nga neni 327 i KPRK-së | Para | P.Th. Prizren | 01.06.2020 |
| **10** | PP/II.nr.2498-11/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 22.12.2020 |
| **11** | PP/II.nr.141-12/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 18.06.2020 |
| **12** | PPN/II.nr.742-12/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 04.11.2020 |
| **13** | PP/I.nr.250/2020 | Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par. 2 të KP-së | Para | P.Th. Prizren | 22.12.2020 |
| **14** | PP/I.nr.234/2020 | Dhënie e ryshfetit nga neni 422 par. 2 të KP-së | Para | P.Th. Prizren | 07.12.2020 |
| **15** | PPN/II.nr.854-9/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 18.12.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **16** | PP/II.nr.2457-11/2020 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshem nga neni 294 të KPRK-së, | Para | P.Th. Prizren | 16.12.2020 |
| **17** | PP/I.nr.163/20 | Blerja, posedimi,shpërndarja e paautorizuuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 15.12.2020 |
| **18** | PP/I.nr.31/2018 | Importi,eksporti, furnizimi, transportim, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe detyrimi nga neni 340 par 2 lidhur me par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 08.12.2020 |
| **19** | PPN/II.nr.496-12/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 20.10.2020 |
| **20** | PP/I.nr.49/2020 | Vrasje e rëndë neni 173 par 1 pika 1.8 lidhur me nenin 31 të KP | Automjet | P.Th. Prizren | 30.10.2020 |
| **21** | PP/I.nr.178/20 | Kontrabandim me migrantë neni 164 par 1 te KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 04.11.2020 |
| **22** | PP/II.nr.1897-9/20 | Vjedhje e pyllit nga neni 358 te KPK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 02.11.2020 |
| **23** | PPN/II.nr.698-5/2020 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga neni 249 të KPRK-së | Para | P.Th. Prizren | 19.10.2020 |
| **24** | PP/I.nr.175/20 | Blerja, posedimi,shpërndarja e paautorizuuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 02.10.2020 |
| **25** | PP/I.nr.184/2020 | Kontrabandim me migrante neni 164 par 1 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Prizren | 15.10.2020 |
| **26** | PP/II.nr.328-13/2020 | Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 312 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Prizren | 01.10.2020 |
| **27** | PP/II.nr.1572/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 06.11.2020 |
| **28** | PP/II/nr.1595/20 | Tregti e ndaluar nga neni 299 par 1. të KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 09.10.2020 |
| **29** | PP/II.nr.1877/20 | Tregti e ndaluar nga neni 299 par 1. të KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 10.12.2020 |
| **30** | PP/II.nr.2013/20 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 14.12.2020 |
| **31** | PP/II 1682/20 | Tregti e ndaluar nga neni 299 par 1. të KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 21.10.2020 |
| **32** | PPN.nr.119/2020 | Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuuar e naroktikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Telefon | P.Th. Mitrovicë | 20.10.2020 |
| **33** | PP/II-1885/20 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 23.10.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **34** | PP/II-1883/20 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 23.10.2020 |
| **35** | PP/II.nr.1627/20 | Falsifikim i dokumentave nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 03.12.2020 |
| **36** | PP/II.nr.1994/20 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshem nga neni 249 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 06.11.2020 |
| **37** | PP/II.nr.1992/20 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshem nga neni 249 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | |
| **38** | PP/II.nr.1975/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 05.11.2020 |
| **39** | PP/II. 2085/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 21.12.2020 |
| **40** | PP/II.nr.2065/20 | Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 të KPRK-së | Para | P.Th. Mitrovicë | 11.12.2020 |
| **41** | PP/II.nr.2055/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Mitrovicë | 09.12.2020 |
| **42** | PP/II.nr.2046/20 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 20.11.2020 |
| **43** | PP/II.nr2064/20 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Mitrovicë | 11.12.2020 |
| **44** | PPN/II.nr.440/20 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 par 3 të KPK-së | Automjet | P.Th. Ferizaj | 15.12.2020 |
| **45** | PP/I.nr.74/20 | Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Para | P.Th. Ferizaj | 26.11.2020 |
| **46** | PPN/II.nr.282/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Ferizaj | 17.11.2020 |
| **47** | PP/II.nr 1436/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Ferizaj | 11.11.2020 |
| **48** | PP.I.nr.153/20 | Blerja, posedimi,shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Ferizaj | 09.10.2020 |
| **49** | PP/II.nr.1146/2020 | Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Ferizaj | 15.10.2020 |
| **50** | PPN/II.nr.373/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Ferizaj | 14.10.2020 |
| **51** | PP/II.nr.1157/20 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 të KPRK-së | Para | P.Th. Ferizaj | 05.10.2020 |
| **52** | PP/II.nr.1842/20 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 29.10.2020 |
| **53** | PPN/II.nr.492/2020 | Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 249 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 03.11.2020 |
| **54** | PPN/II.nr.218/2020 | Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjilan | 20.11.2020 |
| **55** | PPN/II.nr.405/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjilan | 20.11.2020 |
| **56** | PPN/II.nr.544/2020 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 09.12.2020 |
| **57** | PPN.II.377/2020 | Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 312 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 02.10.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **58** | PP/II.nr.2105/2020 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 21.12.2020 |
| **59** | PP/II.nr.2155/2020 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 30.12.2020 |
| **60** | PP/II.nr.18423/2020 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 04.11.2020 |
| **61** | PP/II.nr.1707/2020 | Kontrabandim i mallrave nga neni 311 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Gjilan | 04.11.2020 |
| **62** | PPN.II.nr.247/2020 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjilan | 24.12.2020 |
| **63** | PP/I.nr.134/2020 | Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjakovë | 24.12.2020 |
| **64** | PP/I.nr.102/2020 | Blerja, posedimi,shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjakovë | 05.11.2020 |
| **65** | PP/I.nr.132/2020 | Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Gjakovë | 23.10.2020 |
| **66** | PPN/II.nr.495/2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 09.10.2020 |
| **67** | PP/II.nr.1620/2020 | Hyrje ne sistemin kompjuterik nga neni 327 i KPRK-së | Tjera | P.Th. Pejë | 13.10.2020 |
| **68** | PP/II.nr.1621/2020 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 të KPK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 13.10.2020 |
| **69** | PPN/I.nr.17/2020 | Konflikt i interesit nga neni 417 të KPK-së dhe falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 427 të KPK-së | Tjera | P.Th. Pejë | 13.10.2020 |
| **70** | PPN/II.nr.515.2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 14.10.2020 |
| **71** | PPN/II.nr.532/2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 16.10.2020 |
| **72** | PPN/II.nr.531/2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 16.10.2020 |
| **73** | PPN/II.nr.530/2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 16.10.2020 |
| **74** | PP/II.nr.1735/2020 | Vjedhje e rende nga neni 315 te KPK-se | Tjera | P.Th. Pejë | 22.10.2020 |
| **75** | PPN/II.nr.553/2020 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 22.10.2020 |
| **76** | PPN/II.nr.558/2020 | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 të KPK-së | Para | P.Th. Pejë | 23.10.2020 |
| **77** | PP/I.nr.12/2020 | Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 03.10.2020 |
| **78** | PP/II.nr.1919/2020 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 të KPK-së | Tjera | P.Th. Pejë | 06.11.2020 |
| **79** | PPN/I.nr.198/2020 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 të KPK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 03.11.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **80** | PPN/II.nr.832/2020 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 të KPK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 29.12.2020 |
| **81** | PP/II.nr.2216/2020 | Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshem nga neni 294 par 2 të KPK-së | Para | P.Th. Pejë | 14.12.2020 |
| **82** | PPN/II.nr.683/2020 | Vjedhje e pyllit nga neni 349 të KPK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 20.11.2020 |
| **83** | PP/I.nr.184/2020 | Grabitje nga neni 317 KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 22.10.2020 |
| **84** | PP/I.nr.258/20 | Rrëmbim nga neni 191 par 1 lidhur me nenin 35 të KPRK-së | Automjet | P.Th. Pejë | 02.12.2020 |
| **85** | PPN/II.nr.822/20 | Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së, Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Pejë | 22.12.2020 |
| **86** | PPN/II.nr.684/2020 | Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 të KPRK-së | Tjera | P.Th. Pejë | 23.11.2020 |
| **87** | RNSK.II.nr.56/20 | Vjedhje nga neni 313 i KPK-së | Automjet | P.Th.Pishtinë | 05.11.2020 |
| **88** | PP/I.nr.91K/20 | Marrje e ryshfetit nga neni 421 par 1 të KPRK-së | Telefona | P.Th.Pishtinë | 01.12.2020 |
| **89** | PP/I.nr.462/20 | Keqperdorim i pozitës zyrtare nga neni 414 par 2 dhe 3 pika 3.4 i KPRK-së | Automjet | P.Th.Pishtinë | 21.10.2020 |
| **90** | PPS.nr.72/2020 | Tregti e ndaluar nga neni 299 par 3 lidhur me par 1 te KPRK-së, Shpëlarje e parave, në kundershtim me nenin 302 të KPRK-së lidhur me nenin 32 dhe nenin 56 par 1 lidhur me nënpar 1.5 të Ligjit Nr.05/L-096, për Pastrim të parave dhe luftimin e financimit të terrorrizmit | Para | PSRK | 22.10.2020 |
| **91** | PPS.nr.41/2019 | Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse e cila veprimtari është në kundërshtim me nenin 364 (1) të KPRK-së lidhur me veprën penale: Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par 1 të KPRK-së | Automjet | PSRK | 02.10.2020 |
| **92** | PPS.nr.85/2020 | Shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 134 të KPRK-së | Telefon | PSRK | 22.10.2020 |
| **93** | PPS.nr.88/20 | Keqperdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 414 par 2 dhe 3 pika 3.4 i KPRK-së | Automjet | PSRK | 26.10.2020 |
| **94** | PPN.nr.132/20 | Shpëlarje e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par 1 nenpar 1.1 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorrizmit konform nenit 112 par 1 2.3 dhe 9 të KPRK-së | Automjet | PSRK | 26.10.2020 |
| **95** | PPS.nr.47/2020 | Pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 i KPRK-së, Kontrabandim me migrant nga neni 164 i KPRK-se dhe falsifikim i dokumenteve, rastet e posaqme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 390 dhe 391 i KPRK-së | Tjera | PSRK | 30.10.2020 |
| **96** | PPS.nr.69/2020 | Mashtrim nga neni 323 par 4 lidhur me nenin 31 të KPK | Pajise teknologjike | PSRK | 10.11.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **97** | PPS.nr.57/2020 | Blerja, posedimi,shpërndarja e paautorizuuar e naroktikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1 dhe par 2 të KPRK-së | Para | PSRK | 14.12.2020 |
| **98** | PPN.nr.05.2020 | Shpelarje parash dhe financim të terrorizmit nga neni 302 te KPRK-së lidhur me nenin 33 te Ligjit Nr.05/L-96 | Para | PSRK | 14.01.2020 |
| **99** | PPS/Nr.67/19 | Pastrim parash dhe financim të terrorizmit nga neni 302 të KPRK-së lidhur me nenin 33 te Ligjit Nr.05/L-96, Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm | Automjet | PSRK | 27.10.2020 |

| KONFISKIMET PËR TREMUJORIN IV- TË VITIT 2020 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Numri i Lëndës së Prokurorisë** | **Llojet e aseteve** | **Vepra penale** | **Prokuroria** | **Data** |
| 1 | PP/I.nr.143/2019 | Automjet, telefona | Kontrabandim me migrantë nga neni 164 par 1 dhe 8 pika 1 dhe 2 të KPRK-së | P.Th.Prizren | 26.12.2020 |
| 2 | PP/II.nr.2360-11/2019 | Para, Pajisje teknologjike | Mashtrim neni 323 par 1 dhe nein 31 te KPRK-së | P.Th.Prizren | 02.12.2020 |

| NGRIRJET PËR TREMUJORIN IV- TË VITIT 2020 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Nr. I Prokurorisë** | **Vepra penale** | **Përshkrimi I pasurisë** | **Prokuroria** | **Data** |
| 1 | PP/II.nr.528-16/20 | Mashtrim nga neni 335 par 5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së | Ngastër kadastrale me objekt | P.Th. Prizren | 27.10.2020 |
| 2 | PP/II.nr.2345/20 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th.Peje | 24.12.2020 |
| 3 | PP/II.nr.2232/20 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th.Peje | 16.12.2020 |
| 4 | PP/II.nr.2231/20 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th.Peje | 16.12.2020 |
| 5 | PP/II.nr.2230/20 | Legalizim i përmbajtes së rreme nga neni 395 i KPRK-së | Automjet | P.Th.Peje | 16.12.2020 |
| 6 | PPS.nr.88/20 | Keqperdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 414 par 2 dhe 3 pika 3.4 i KPRK-së | Llogari | PSRK | 23.10.2020 |
| 7 | PPS.96/20 | Shpëlarje e parave nga neni 302 të KPRK-së | Ngrirje e llogarise | PSRK | 06.11.2020 |
| 8 | PPS.nr.10/2019 | Shpëlarje e parave, në kundërshtim me nenin 302 të KPRK-së lidhur me nenin 56 (1) të Ligjit nr. 05/L-096 "për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit vepër kjo e listuar në nenin 90 të KPK-së | Shtëpi dhe prona | PSRK | 18.12.2020 |

| 9 | PPS/Nr.67/19 | Pastrim parash dhe financim të terrorizmit nga neni 302 të KPRK-së lidhur me nenin 33 te Ligjit Nr.05/L-96, Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm | Prona | PSRK | 27.10.2020 |
|---|---|---|---|---|---|

VËREJTJE: Për rastet nën numrta rendor 2, 3, 4, PTH Peja ka sqaruar se në të vërtetë është fjala për sekuestrim e jo ngrirje.

## 9. Sekuestrimet vs veprat penale

- Veshëmbathje janë sekuestruar nga vepra penale: Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore;
- Para, pajisje teknologjike, janë sekuestruar nga vepra penale: Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm;
- Para, 2 automjete janë sekuestruar nga vepra penale: Shpelarje parash dhe financim të terrorizmit;
- 1 automjet, 1 biciklетë janë sekuestruar nga  nga vepra penale: Vjedhje;
- 7 automjete para janë sekuestruar nga vepra penale: Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge;
- 21 automjete dhe para janë sekuestruar nga vepra penale, Falsifikim i dokumentit;
- 1 automjet është sekuestruara nga vepra penale: Grabitje;
- 2 automjete, pajisje teknologjike, artikuj ushqimor, pajisje bujqësore, janë sekuestruar nga vepra penale: Kontrabandim i mallrave;
- 5 automjete janë sekuestruar nga vepra penale: Kontrabandim me migrantë;
- 1 parcelë, pajisje teknologjike janë sekuestruar nga vepra penale: Mashtrim;
- 6 automjete nga vepra penale: Legalizim i përmbajtes së rreme;
- Para janë sekuestruar nga vepra penale: Dhënie ryshfeti;
- 1 automjet, artikuj të ndryshëm dhe cigare janë sekuestruar nga vepra penale, Tregti e ndaluar nga neni 299 par 1 i KPRK-së;
- 6 automjete, 1 motor sharrë, drunj, janë sekuestruar nga vepra penale: Vjedhje e pyllit;
- 1 automjet nga vepra penale: Rrëmbim;
- 1 automjet nga vepra penale: Vrasje e rëndë;
